



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C (1)

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 60 seminare;

Viti / Semestri : Viti 1, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master në “Mësuesi”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studentët janë në gjendje të zhvillojnë biseda mbi tema të njohura dhe më komplekse të shprehin dhe të mbrojnë mendimin e tyre gjatë diskutimeve. Të tregojnë mbi përvojat dhe për ngjarje të kaluara si dhe për plane për të ardhmen. Të shkruajnë tekste të gjata dhe të strukturuar, në formë raportesh, letrash, komentesh, e-mailesh etj. Të përdorin fraza lidhëse midis fjalive për të krijuar tekste koherente

Objektivat specifike lëndore:

1. Të shprehin rrjedhshëm në situata të jetës së përditshme
2. Të marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutime.
3. Të zhvillojnë strategji për të mësuar në mënyrë të pavarur.
4. Të kuptojnë më mirë dallimet kulturore dhe të përballen me normat dhe traditat kulturore në vendet gjermanishtfolëse.

Rezultatet të pritshme:

Lënda "Gjermanishtja si gjuhë e dytë" në nivelin gjuhësor B1.2 synon të zhvillojë më tej njohuritë gjuhësore të nxënësve, në mënyrë që ata të komunikojnë më sigurt dhe më rrjedhshëm në situata të përditshme, profesionale dhe shoqërore. Kursi promovon zgjerimin e fjalorit dhe strukturave gramatikore si dhe thellimin e aftësive komunikuese, të shkrimit dhe të folurit